

RAPORTI TEKNIK

I

PROJEKTIT TË PROPOZUAR.

a) Qëllimine projektit të propozuar.

Subjekti SEP INTERNATIONAL sh.p.k. është regjistruar në Q.K.R. në datë 21/07/2015, me NIPT L56929001B. Administratore e këtij subjekti është znj. Edra ABAZI. Fusha e veprimtarisë së këtij subjekti është : ***Prodhim dhe tregtim pellet, punim dhe tregtim druri.***

Qëllimi i projektit të propozuar është përpunimi i lëndëve drunore të klasifikuara mbetje teknologjike, për prodhimin e peletave, të cilat përdoren gjërësisht si lëndë djegëse. Mbetjet teknologjike, të lëndës drusore janë ato që dalin gjatë shfrytëzimit të parcelave pyjore si degë e gjethe, lëvore dhe copa trungjesh, të cilat nuk gjejnë tjetër vend përdorimi dhe që zakonisht mbeten në vendet e shfrytëzimit të pyllit dhe degradojnë drejt kalbëzimit. Mbetje të tjera teknologjike drusore janë edhe ato që dalin gjatë përpunimit të drurit për prodhim mobiljesh, karrikesh, dyer e dritare etj.

Përpunimi i këtyre lloj mbetjesh teknologjike, për prodhim pelete, kategorizohet si riciklim apo rikuperim. Nenin 3 **Përkufizime**, i Ligjit Nr.10 463, datë 22.09.2011 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE” jep këtë shpjegim për termin rikuperim.

“**Rikuperim**” është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:

- i. mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdreshin në rast të kundërt për të përbushur një funksion të caktuar;
- ii. mbetjet të përgatiten për të përbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë. Në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij ligji, jepet një listë joshtruese e operacioneve të rikuperimit.

SHTOJCA 2 OPERACIONET E RIKUPERIMIT

R 1 Përdorimi kryesisht si lëndë djegëse ose mënyra të tjera për prodhimin e energjisë.

Duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\text{Eficienca e energjisë} = \{ E_p - (E_f + E_i) \} / \{ 0,97 \times (E_e + E_f) \}$$

Ku:

E_p - është energjia vjetore e prodhuar si nxehtësi ose elektricitet. Është llogaritur me energji në trajtë elektriciteti shumëzuar me 2,6 dhe nxehtësi e prodhuar për përdorim tregtar e shumëzuar me 1,1 (GJ/vit).

E_f - është inputi vjetor i energjisë në sistem nga lëndët djegëse që kontribuojnë në prodhimin e avullit (GJ/vit).

E_e - është energjia vjetore që përmbahet në mbetjet e trajtuara të llogaritura, duke përdorur vlerën kalorifike neto të mbetjeve (GJ/vit).

E_i - është energjia vjetore e importuar duke përjashtuar E_e dhe E_f (GJ/vit).

0,97 - është një faktor që merr parasysh humbjet e energjisë për shkak të hirave fundorë dhe rrezatimit

R 12 Shkëmbimi i mbetjeve për t'iu nënshtruar cilitdo nga operacionet e renditura nga R 1 deri tek R 11. Në qoftë se nuk ka një kod tjetër të përshtatshëm R, ky mund të përfshijë operacionet paraprake para rikuperimit përfshirë para-përpunimin siç është, interalia, çmontimi, grumbullimi i diferencuar, **thyerja/copëtimi, ngjeshja, peletizimi, tharja, grirja, zbutja, riambalazhimi**, ndarja, bluarja **apo përzierja para dorëzimit në cilindo nga operacionet** e numëruara R1 deri R11.

Nga shpjegimet e mësipërme është e kuptueshme që zbatimi i projektit të propozuar, ka për qëllim rikuperimin e mbetjeve teknologjike dhe natyrore të lëndëve drunore, për të prodhuar prej tyre peleta. Peletat, përdoren si lëndë djegëse në fusha të ndryshme si p.sh. në sistemet ngrohëse me ujë të godinave, në kaladajat e industrisë ushqimore, etj.

- b) Planimetrinë e vendndodhjes së projektit,(ku pasqyrohen në hartëtopografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat,sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë).

Impjanti i prodhimit të peletave, është instaluar në një prej godinave të zonës industrial të Qytetit të Shkodrës.

Zona industriale e Shkodrës ndodhet në periferinë very-lindore të qytetit ku bizneset kryesore operuese janë fasonistë (lëkurë, këpucë dhe konfeksione), prodhim kablllo elektrik, përpunim druri, prodhime sallamerie, ëmbëlsira etj.

Objekti ndodhet tërësisht i përfshirë në zonën industrial, duke nënkuptuar që të gjitha kufizimet gjeografike të tij, janë me godina të ndëryshme të kësaj zone, dhe në kufirin lindor ka lidhje të drejtëpërdrejtë me rrugën automobilistike të kësaj zone industrial. Kjo bën të mundur lidhjen me rrugë automobilistike me rrugët kombëtrae, nëpërmjet bashkimit të saj me Rrugën Lëvizja e Postribës”.

Në afërsi të këtij objekti nuk gjenden banesa apo objekte sociale, sepse kemi të bëjmë tërësisht me përfshirjen e tij brenda teritorit të zonës industrial.


Të katër konturet ekstreme të objektit, kryqëzohen në pikat me koordinatat:

$$X1 = 460918.48 \quad X2 = 460948.36$$

$$Y1 = 4661153.52 \quad Y2 = 4661179.00$$

$$X3 = 461014.57 \quad X4 = 460987.78$$

$$Y3 = 4661111.86 \quad Y4 = 4661083.70$$



- c) Informacionin për qendrat e banuara, nëzonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria që ne vlerësojmë, është në juridiksionin e Bashkisë Shkodër. Ai gjendet në zonën industriale të këtij qytetit, në pjesën verë-lindore disa dhjetra metra në perëndim të kryqëzimit të Rrugës Lëvizja e Postribës, me rrugën e kësaj zone industriale. Objekti është tërësisht i vendosur brenda zonës industriale dhe nuk ka banesa apo objekte sociale në afërsi të tij.

Qarku Shkodër është një qendër e rëndësishme ekonomike e vendit. Në shkallë vendi, ai zë:

- vendin e parë në prodhimin e energjisë elektrike,
- vendin e dytë në prodhimin e industrisë së drurit,
- vendin e tretë në prodhimin bujqësor.

Aktualisht, aktivitetet kryesore ekonomike në qarkun e Shkodrës janë të përqendruara në ndërtim dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit, industrinë e lehtë (agro-industria, industria e përpunimit të drurit, fasonët etj.), agrobiznesi, tregti, shërbime etj

Vizioni i rajonit të Shkodrës është zhvillimi i qëndrueshëm, qw kuptojmë jo vetëm rritjen industriale, por krahas saj edhe mbrojtjen e indikatorëve të mjedisit i cili është element thelbësor dhe shumë i rëndësishëm për zhvillimin normal të aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen në kwtw mjedis.

Qyteti i Shkodres ka nje siperfaqe prej 2703.8 ha dhe nje popullsi prej 115.625 (viti 2012).Qyteti është i vendosur kryesisht në rafshinë. Në drejtimin jugperëndim-verilindje ka kuotat nga 9.5 m deri në 24 m mbi nivelin e detit. Në veriperëndim të tij ndodhet Liqeni i Shkodrës.Pjesa kryesore fushore e qytetit sot ka një shtrirje prej 1150 ha.

Nga ana lindore qyteti kufizohet nga Lumi i Kirit që buron nga Malësitë e Veriut Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore.Nga liqeni buron Lumi i Bunës që derdhet në detin Adriatik Shkodra nga ana lindore dhe jugore rrethohet nga nje varg kodrash deri në 110 m lartësi, kodrat e Rrencit në lindje dhe të Tepes në jug. Në jugperëndim gjendet kodra shkëmbore e kalasë së Rozafës.

- ç) Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit.

Bashkangjitur janë disa prej fletëve më kryesore të projekteve të këtij objekti tashmë të përfunduari së rikonstruktuari në përshtatje me proceset teknologjike që do të zhvillohen aty.

Kemi të bëjmë me një objekt të ndërtuar që para viteve 1990, dhe që tani është rikonstruktuar duke u përshtatur me aktivitetin që do zhvillohet aty. Kështu kanë përfunduar të gjitha llojet e punimeve ndërtimore, të godinës dhe të rrjeteve inxhinjerie si dhe kanë përfunduar punimet për instalimin e makinerive dhe pajisjeve të linjës teknologjike të prodhimit të peletave.

- d) Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit.

- i. Përshkrimi i proceseve ndërtimore.

Impjanti i prodhimit të peletave është instaluar në një prej objekteve egzistuese të zonës industrial të Qytetit të Shkodrës. Në këtë godinë kanë përfunduar të gjitha punimet për rikonstruksionin e saj, riparime dhe përshtatje hapsirash me veprimtarinë që do

zhvillohej. Njëkohësisht kanë përfunduar edhe të gjitha llojet e punimeve për lidhjen me rrjetet inxhinjrike në shërbim të kësaj veprimtarije.

Në këto kushte, ne nuk mund të bëjmë përshkrimin e proceseve ndërtimore.

ii. Përshkrimi i proceseve teknologjike.

Pjesë e përshkrimit të proceseve të prodhimit të peletës, është edhe skema teknologjike në vijim, në të cilën janë paraqitur makineritë dhe pajisjet e instaluara si dhe lidhja e tyre teknologjike, nga përpunimi i lëndës së parë deri në realizimin e produktit të gatshëm për treg. Në të përshkruhen zonat në vijim :

- Zona 1 – grirëset e mbetjeve drusore.
- Zona 2 – heqja e lagështisë sipërfaqësore ose tharja e lëndës së parë.
- Zona 3 – pajisjet e kapjes së pluhurave, që dalin gjatë tharjes
- Zona 4 – pajisjet kryesore të kapjes së pluhurave
- Zona 5 – pajisjet e presimit dhe të formimit të peletave
- Zona 6 – pajisjet e ambalazhimit të prodhimit të realizuar.

Në këtë linjë teknologjike me një kapacitet prej rreth 3 ton/orë prodhim peleti, lëndë e parë që përdoret janë mbetjet drusore, si :


- tallashi e copra druri që dalin gjatë proceseve të prodhimit të mobiljeve, dyerve e dritareve, karrikeve etj.
- degë e lëvore të pemëve gjatë shfrytëzimit të parcelave pyjore si dhe gjatë përpunimit të trungjeve për nxjerrjen e dërrasës;
- mbetje të kopshteve e parqeve private e public, kryesisht degë pemësh e gjethes;
- lëvozhga të arrave, bajameve, lajthive, farat e ullinjve e të frutave të ndryshme etj. nga linja të prodhimeve ushqimore.

E gjithë kjo sasi lënde e parë, kalon në procesin e grirjes apo të coptimit, duke krijuar një përzierje fizike të llojeve përbërës, në madhësi grimacash pak a shumë uniforme. Pajisja grirëse me çekica e prodhimit italian, ka një kapacitet përpunues rreth 20 m³/ditë.

Duke analizuar përmbajtjen e lagështisë sipërfaqësore të lëndës së parë të pregatitur (përmbajtja optimale e lagështisë është 10-15 %), coptuar përcaktohen parametrat teknologjikë të tharësit, siç janë:

- temperatura e zonës së djegies së lëndës djegëse pra, e zonës së tharjes
- sasia e materialit që do kalojë në tharës
- etj.

Kjo pajisje përdor si lëndë djegëse një sasi prej rreth 600 kg/orë, tallash druri ose peletë të prodhuar aty.





Produktet e djegies duke lëvizuar përgjatë pajisjes tharëse, mbartin me vete grimca të imta të lëndës që kalon në këtë proces. Për kapjen e tyre, në dalje të pajisjes tharëse është instaluar një bateri ciklonësh, të cilët bëjnë të mundur kapjen e grimcave të ngurt, dhe pastrimin e gazeve që shkarkohen në atmosferë.

Grimcat e ngurta rikthehen në procesin e prodhimit të peletës duke u bashkuar me produktin e tharë dhe duke kaluar në procesin e formimit të peletës.

Janë instaluar disa pajisje formuese të peletës, parimi i punës të të cilave është formimi nën efektin e ngjeshjes së materilit të coptuar e të tharë, pa përdorur lëndë apo substance ngjitëse. Pelleti formohet/lidhet nga kohezioni i sipërfaqeve tëkokrrizave brenda tij, nga pjesët fibrore të grimcave dhe kryesisht nga adezioni i shkaktuar nga linjini qëështë zbutur nga nxehtësia qëmbartin me vete këto lëndë si dhe ajo që krijohet gjatë ngjeshjessë tyre. Peletat e formuarara në formë cilindrike apo sferike kanë përmasa 6-12 mm

Peletat e formuar kalojnë më pas në pajisjet e amabalazhimit të tij. Këto pajisje kanë pjesë të tyre :

- mbajtësen e thesit plastik apo prej letre;
- dozatorin;
- peshoren;
- pajisjen e mbylljes/qepjes së thesit të mbushur.

Proçeset teknologjike të përpunit të lëndëve të ndryshme drusore, si coptimi, tharja, presimi, transportimi dhe ambalazhimi, shoqërohen me prani apo gjenerim të grimcave të imta të kësaj lënde (tallashi tharë) me peshë relativisht të lehtë.Për të minimizuar apo eliminuar daljen e tallashit, nga pajisjet teknologjike ku zhvillohen këto proçese, është kryer instalimi i një sistemi aspirimi dhe pluhur-kapje.Pajisja kryesore e këtij sistemi është pluhur-kapësi me mëngë, një pajisje me rendiment të lartë deri në 99 %, në kapjen e pluhurave të kësaj natyre.Të gjithë pluhurat e tallashit të kapur këtu, rikthen në procesin e formimit të peletave.

Kjo zgjidhje teknologjike, zvogëlon ndjeshëm humbjet fizike të lëndës së parë dhe njëkohësisht zvogëlon efektet negative në mjediset e vendeve të punës dhe më gjërë, nga prania e grimcave të tallashit.

Pajisjet e instaluar në këtë linja teknologjike janë të lidhura në mënyrë teknike me njera tjetrën, duke patur një sistem kontrolli dhe komandimi unik. Ato punojnë në mënyrë të sinkronizuar në raport me sasinë e lëndës që trajtojnë, parametrat teknologjik që duhet të realizojnë etj.Çdo difekt apo anomali e çfaqur në njërën prej tyre reflekton në ndërprerjen

e punës në të gjithë linjën apo në prishjen e treguesve cilësor të prodhimit. Kjo linjë ka kapacitet prodhues prej 3 ton/orë ose në rreth 530 ton/muaj pelletë.

dh) Informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja.

Zona industrial e konceptuar dhe ndërtuar me në funksion të zhvillimit të disa veprimtarive prodhuese industriale. Ajo ishte e plotësuar me të gjithë rrjete inxhinjrike përkatëse të furnizimit me energji, ujë, rrjet të shkarkimit të ujrave të zeza dhe ujrave industrial të ndotur si dhe me rrjetin rrugor të brendëshëm e të lidhur normalisht me rrjetin rrugor kombëtar.

Objekti në të cilin është instaluar linja e prodhimit të pelletit, duke qënë pjesë e objekteve të kësaj zone industriale, është i lidhur me rrjetet inxhinjrike të kësaj zone.

i. furnizimi me energji elektrike.

Energjia e nevojshem elektrike, merret nga rrjeti i zoëns industrial, sipas kontratës me Drejtorinë rajonale të OSHS Shkodër. Është rikonstruktuar rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike për furnizimin e elektromotorrëve të makinerive e pajisjeve si dhe për sistemet e ndriçimit të ambjenteve të brendëshme dhe të jashtme të punës, rrugëve dhe shesheve të zhfrytëzuara nga ky subjekt. Rrjeti shpërndarës është i kompletuar me pajisjet e duhura të lëshimit/ndalimit të pajisjeve, të kontrollit të parametrave teknik të rrymës elektrike, të mbrojtjes nga mbingarkesat e mundëshme etj. Ky rrjet është i aftë teknikisht të përballojë një fuqi të instaluar prej rreth 300kWh.

ii. furnizimi me ujë, industrial dhe ujë të pijshëm.

Uji industrial i nevojshëm për zhvillimin normal të kësaj veprimtarije merret nga rrjeti i furnizimit me ujëi zonës industrial, mbështetur në kontratën e hartuar ndërmjet subjektit që administron këtë ujësjellës.

Uji nuk është pjesmarrës i asnjë proces teknologjik që zhvillohet në këtë veprimtari. Ai përdoret kryesisht për ftohjen e disa pajisjeve, për nevoja komunale në ambjentet hidro-sanitare dhe për pastrimin e ambjenteve të punës. Sasia mesatare e konsumit të ujit industrial është rreth 3m³/muaj.

Brenda objektit është ndërtuar rrjeti i shpërndarjes së ujit industrial në të gjitha pikat e konsumit të tij.

Uji për pirje, blihet i ambalazhuar në shsishe plastike, nga subjekte të liçensuar që merren me tregtimin e tij. Sasia mesatare e konsumit mujor të ujit të pijshëm është rreth $0.5 \text{ m}^3/\text{muaj}$.

iii. rrjetii shkarkimit të ujrave “të ndotur”.

Për mbledhjen e të gjitha llojeve të ujrave që shkarkohen gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarije është ndërtuar një rrjet i brendëshëm tubacionesh. Ky rrjet mbledh ujrata që shkarkohen nga ambientet hidro-sanitare, ujrata që dalin gjatë pastrimit të ambjenteve të punës si dhe ujrata e shirave. Rrjeti është i lidhur me kolektorin e rrjetit të shkarkimeve të zonës industriale, i cili shkarkon në Lumin Kir.

iv. Rrjeti rrugor.

Objekti është i lidhur me rrjetin rrugor të zonës industriale dhe nëpërmjet tij me rrjetin rrugor kombëtar. Në kufirin jug-lindor, të objektit kalon rruga kryesore e zonës industriale, e cila lidhet me Rrugën Lëvizja e Postribës, dhe më tej me rrjetin kombëtar të rrugëve automobilistike. Aktualisht nuk ka nevojë për hapje rrugësh të reja.

v. Sisteme të mbrojtjes nga zjarri.

Në linjat teknologjike të përpunimit të lëndëve drusore, rrizku i rënies së zjarreve vlerësohet i lartë. Është detyrë ligjore e administratorit të subjektit, që të plotësojë objektin me mjetet sinjalizuese të lindjes/krijimit të vatrave të zjarrit si dhe mjetet e duhura të shuarjes së zjarreve të mundëshme.

Në objekt janë të vendosura disa fikse zjarri, të vëllimit 6-9 litra me shkumë dhe pluhur. Është e rekomandueshme nga ana jonë që të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i kësaj gjendjeje, në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri të Qarkut/Prefekturës Shkodër, me qëllim që të përcaktohen saktë numuri, llojet dhe madhësitë e fikseve të zjarrit që duhen instaluar në këtë objekt.

vi. Shkarkimi i ujrave “të ndotur”.

Në zhvillimin e kësaj veprimtarije uji nuk është pjesmarrës i drejtpërsëdrejti në procesin teknologjik. Uji përdoret :

- si element ftohës në disa pajisje teknologjike, duke punuar në një sistem qarkullimi të mbyllur.
- Si element për pastrimin e ambjenteve të punës dhe
- Si element që përdoret në ambientet hidrosanitare.

Ujra që shkarkohen janë ato që dalin nga ambientet hidrosanitare (kryesisht ujra të zeza) si dhe ujrata që dalin nga pastrimi i ambjenteve të punës. Gjatë pastrimit të ambjenteve ujrata mund të ndoten zakonisht me grimca të ngurta, kryesisht tallash.

vii. Mbetjet e ngurta.

Nuk gjenerohen mbetje teknologjike të ngurta nga zhvillimi I kësaj veprimtarije. Këtu gjenerohen mbetje të ngurta urbane që përbëhen kryesisht nga përmbajtja e letrës/kartonit, plastikës, qelqit etj.

- e) Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit.

Në kapitujt paraardhës të këtij raporti, kemi shpjeguar se kemi të bëjmë me një objekt të ndërtuar vite më parë që është pjesë e një kompleksi ndërtimesh të një zone industriale. Në momentin e vizitës vlerësuese në objek, konstatohet se në të kanë përfunduar të gjitha llojet e punimeve të ndërtimit, që ishin parashikuar nga investitori për riparimet e mundëshme, në përshtatje me linjën teknologjike që është instaluar. Kanë përfunduar gjithashtu edhe punimet për lidhjen dhe përshtatjet e mundëshme me rrjetet inxhinjerie dhe njëkohësisht kanë përfunduar edhe të gjitha punimet për instalimin e makinerive dhe pajisjeve të prodhimit të peletës.

Ky investim është në hapat e para të zhvillimit të tij, nga korriku 2015 dhe ne mendojmë se është akoma shpejt për të vlerësuar kohëzgjatjen e zhvillimit të këtij aktiviteti.

Duke vlerësuar kërkesat e këtij kapitulli, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarije nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës industrial ku ai zhvillohet. Ky arsyetim, rezulton nga vlerësimi se do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër. Është një zonë e tërë e tjetërsuar para më shumë se 30 vitesh, në zonë industrial, në të cilën kanë humbur të gjitha gjurmët që mund të tregojnë si ka qënë ajo, në kuptimin e pranisë dhe zhvillimit të florës dhe faunës në të.

Në planet rregulluese urbanistike të Bashkisë e Qarkut Shkodër, kjo zonë vijon të vlerësohet si zonë industrial dhe besojmë se e tillë do të mbetet edhe në prespektën e afërt apo të mesme.

- ë) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji).

Dukeqënëse, kanë përfunduar të gjitha proceset e mundëshme ndërtimore, nuk mund të japim shpjegime mbi kërkesat e këtij kapitulli.

- f) Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit.

Projekti që zhvillohet është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me projekte të tjera që zhvillohen në këtë zonë industriale. Lidhja qëndron në influencat reciproke, të përshkruara në vijim:

- Nga përdorimet e rrjeteve inxhinjrike, rrugëve e shesheve të përbashkëta;
- Nga shkarkimet e lëndëve/sumbstances të ndryshme në ajër, ujë dhe tokë;
- Nga aksidentet e mundshme teknologjike, apo situatat emergjente që mund të zhvillohen aksidentalisht në njerin prej këtyre aktiviteteve;

- g) Informacioni për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret.

Zgjedhja e vendndodhjes vlerësohet pozitivisht, nisur nga disa argumente të cilët i pasqyrojmë në mënyrë të përmbledhur në vijim:

- Qarku i Shkodrës ka një zhvillim të qëndrueshëm të zhvillimit të shfrytëzimit të pyjeve dhe të përpunimit të lëndës drusore;
- Procesi i përpunimit të mbetjeve teknologjike drusore bëhet në një zonë industriale, të ndërtuar para më shumë se 30 vitesh, duke mos cënuar dhe tjetërsuar kështu troje apo sipërfaqe toke.
- Objekti dhe rrjetet inxhinjrike, rrugore etj. janë të ndërtuara dhe funksionale për teknologjinë e instaluar.
- Ka një presion relativisht më të vogël, nga organet vendimarrëse dhe publiku i interesuar për zhvillim të këtij aktiviteti në një zonë të vlerësuar industriale, në raport me zona të tjera me ndjeshmëri ndaj mjedisit, në këtë rajon.
- Mundësi të mëdha në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar në shfrytëzimin e linjave industriale, duke zbutur kështu disa problemet sociale të komunitetit.

Zgjedhja e teknologjisë vlerësohet pozitivisht, nisur nga argumentat se ajo është e importuar nga një vend i zhvilluar i BE si Italia. Këtu janë instaluar makineri e pajisje të njohura për prodhimin e peletave. Linja teknologjike punon me parametra teknik të përshtatshëm jo vetëm për prodhimin që realizohet por, edhe për treguesit e tij miqsor me

mjedisin. Për ilustrim, përmendim që këtu përdoret si lëndë djegëse rreth 20 % e sasisë së peletës së prodhuar.

- gj) Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasisë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre.

Lënda e parë që përdoret në këtë veprimtari është ajo drusore, në formën e mbetjeve teknologjike si, copra druri e tallashi që dalin nga linjat e prodhimit të mobiljeve, karrike, dyerve e dritareve. Krahas tyre përdoren edhe lëndë drusore që del si mbetje gjatë shfrytëzimit të parcelave pyjore si degë, trungje, lëvore të pemës që pritët. Po kështu mund të përdoret edhe mbetje të dala nga kopshtet apo parqet publike e personale.

E gjithë kjo sasi lënde drusore e vlerësuar apo e kategorizuar mbetje, kalon nëpër disa operacione teknologjike deri në prodhimin e peletës. Ky produkt ambalazhohet dhe tregtohet duke u përdorur si lëndë djegëse në subjekte apo individë familjarë, në sistemet e ngrohjes së banesave, objekteve sociale, humane (spitale) etj.

Funksionimi normal i kësaj veprimtarie kërkon përdorimin e :

- i. Energjisë elektrike për një fuqi të instaluar prej 300 kWh, me një konsum mesatar prej 47500 kw/muaj;
- ii. Ujit industrial në një sasi prej 3m³/muaj;
- iii. Lëndë djegëse :
 - Peletë rreth 600kg/orë puneme një konsum mesatar prej 105600 kg/muaj;
 - Naftë rreth 300 litra /muaj.

Energjia elektrike dhe uji, blihen nga subjektet që administrojnë këto energji, në bazë të kontratave të hartuara mes palëve.

Peleta e përdorur si lëndë djegëse, është prodhim i vetë subjektit.

Nafta aktualisht blihet drejtpërsëdrejti në pikat e karburantit, por po bëhen përpjekjet e nevojshme për gjetjen e modeliteve të përbashkëta me subjekte që merren me tregtimin me shumicë të naftës, për hartimin e kontratave përkatëse.

- h) Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Nuk është e nevojshme ngritja e kampeve apo rezidencave, për zbatimin e këtij projekti, për arsye se :

- Zona industrial është jo shumë larg qendrave të banuara, duke bërë të mundur pjesmarrjen e punonjësve të kualifikuar, si dhe lehtësi të lëvizjes së tyre.
 - Nuk kërkohet pjesmarrje në numur të madh tëpunëtorëve në zhvillimin e veprimtarisë.
 - Subjekti ka siguruar transportin e punëtorëve të tij, në fillimin dh embarimin e punës, për çdo ditë.
- i) Informacioni për lejet, autorizimet dhe liçencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/ autorizimin/liçencimin e projektit.

Ligji Nr. 6/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesane Ligjin nr.10081, datë 23.02.2009,“për liçencat, autorizimet dhelejet në Republikën e Shqipërisë”, nuk përcakton marrjen e liçensave/lejeve për zhvillimin e këtij aktiviteti.

- j) Kopje të lejeve, autorizimeve dhe liçencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacioni në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/liçencimin e projektit.

Subjekti ka disa muaj që ka filluar nga aktiviteti, nga Korrik 2015.Është një periudhë realisht e shkurtër, që më shumë ka shërbyer për të vlerësuar dhe korigjuar zbatimin e procesit teknologjik dhe punën e pajisjeve të instaluara.Aktualisht, subjekti ka bërë vetëm rregjistrimin në QKR.Janë programuar që të pregatiten dokumentacionet e kërkuara ligjore për marrjen e lejeve, autorizimeve dhe liçencave në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacioni në fuqi, dhe paraqitjen e tyre tek institucionet kompetente për kompletimin e subjektit me lejimin/autorizimin/liçencimin.Në këtë kuadër është edhe përgatitja e dokumentacionit të kërkuar për marrjen e Lejes së Mjedisit Tipi B.